

VENDIM
Nr. 1101, datë 1.11.2019

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. AGIM YMER KAJMAKU, ME FUNKSION KRYETAR I BASHKISË VORË, QARKU TIRANË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 1.11.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement Zguri, kryetar

Denar Biba, zëvendëskryetar

Bledar Skënderi, anëtar

Edlira Jorgaqi, anëtare

Rezarta Bitri, anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë, qarku Tiranë, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa “d”, i ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; kreu III, pika 3, germa “ç” i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve,

VËREN

I

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit, për subjekte si më poshtë:

- deputetë të Kuvendit të Shqipërisë;
- Kryeministrit apo anëtarit të Këshillit të Ministrave që nuk është deputet;
- kryetarit të bashkisë apo këshilltarit në këshillin bashkiak;
- kandidatët për deputet dhe në organet e qeverisjes vendore.

Z. Agim Ymer Kajmaku, aktualisht me funksionin kryetar i Bashkisë Vorë, në datën 13.5.2019, referuar ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, së bashku me dokumentacionin e kandidimit ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe formularin e vetëdeklarimit me nr. unik 3253.

Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të z. Agim Ymer Kajmaku, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë në lidhje me dënim me vendim të formës së prerë nga autoritete gjyqësore shqiptare apo të huaja, dënime me vendime jopërfundimtare nga autoritete gjyqësore

shqiptare apo të huaja, masa sigurimi personal, urdhërndalimi ndërkombëtar, ndalime nga organet ligjzbatuese, dëbime apo hetime brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Në rubrikën I.B të formularit të vetëdeklarimit, ka deklaruar gjenealitete të mëparshme Jorgo Toto, ndërsa në rubrikën III.8 ka deklaruar se ka jetuar për më shumë se 1 (një) muaj jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në Athinë, Greqi për arsye emigracioni për periudhën 1991–1996 dhe në Ascoli Picena, Fermo, Itali, për arsye biznesi përgjatë periudhës 1998–1999.

Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe kreut V, pika 2, germa ‘b’ dhe pika 3, germa ‘c’, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 3669 prot, datë 16.5.2019, dhe nr. 3695 prot, datë 16.5.2019, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, për verifikimin e të dhënave për funksionarët publikë që kanë dorëzuar formularët e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Nga ana e zyrës së gjendjes gjyqësore, me shkresën nr. V-1525/1 prot, datë 17.5.2019, është dërguar verifikimi i gjendjes gjyqësore për të gjithë funksionarët publikë që kemi kërkuar, nga ku rezulton se subjekti vetëdeklarues z. Agim Kajmaku është i padënuar. Përgjigja nga zyra e gjendjes civile për këtë funksionar publik nuk ka ardhur akoma në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Duke qenë se z. Agim Ymer Kajmaku ka kandiduar për zgjedhjet e qeverisjes vendore të datës 30.6.2019, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të dispozitave të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, bëri verifikimin e të dhënave në formularin e vetëdeklarimit për këtë funksionar publik. Nga verifikimi i të dhënave në formularin e vetëdeklarimit, përgjigjes së ardhur nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve rezultoi se kandidati nuk ishte në kushtet e moszgjedhshmërisë dhe me vendimin nr. 470, datë 17.5.2019, vendosi njoftimin e KZAZ-së për vazhdimin e procedurave për regjistrimin e kandidatit për kryetar, Bashkia Vorë, qarku Tiranë, të propozuar nga koalicioni “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

II

Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 2193/2, datë 23.8.2019, i ka kërkuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve verifikimin e të dhënave të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit për z. Agim Ymer Kajmaku.

Pas verifikimit të formularit në përputhje me nenin 15, pika 1, të ligjit 138/2015 dhe kreu VI, pika 6, kreu V, pika 3, germa ‘b’ e vendimit të Kuvendit 17/2016, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me shkresën nr. 14197 prot, datë 27.8.2019, ka përcjellë të dhënat e administruara nga KQZ-ja për kontroll të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, për funksionarin publik z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë, qarku Tiranë.

Me shkresën nr. 2193/68 prot, datë 28.10.2019, Prokurori i Përgjithshëm, Sektori i Verifikimit të Integritetit, pranë Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në Prokurorinë e Përgjithshme, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve vendimin e rezultatit të verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015, për subjektin z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë.

Sipas vendimit të Prokurorisë së Përgjithshme “Për miratimin e rezultatit të verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015, për subjektin z. Agim Ymer Kajmaku, me funksion kryetar i Bashkisë Vorë” rezulton se:

Më datë 23.8.2019 është depozituar në Prokurorinë e Përgjithshme kërkesa e Partisë Demokratike, me objekt “Verifikimin e pastërtisë së figurës së shtetasit Agim Kajmaku alias Jorgo Toto”. Në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e

integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, kërkesa është shoqëruar me nënshkrimet e jo më pak se 500 shtetasve me të drejtë vote.

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve me shkresën nr. 2629/1 prot, datë 27.8.2019 ka vënë në dispozicion të Prokurorisë së Përgjithshme dokumentin “Vërtetim i gjendjes gjyqësore nr. 11 prot, datë 27.8.2019, sipas të cilës rezulton se z. Agim Ymer Kajmaku (Jorgo Toto), figuron “i padënuar” brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 6854/1 prot, datë 29.8.2019, ka paraqitur në Prokurorinë e Përgjithshme të dhënat personale të subjektit Agim Ymer Kajmaku, sipas Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile. Referuar këtyre të dhënave rezulton se subjekti në datën 6.2.1996, ka ndryshuar përbërësit e gjendjes civile, rubrikën e emrit/mbiemrit nga “Agim Kajmaku” në “Jorgo Toto”. Në datën 30.3.2004, rezulton t’i ketë ndryshuar përsëri këto përbërës nga “Jorgo Toto” në “Agim Kajmaku”.

Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme në sistemin TIMS, rezulton se z. Agim Kajmaku, me atësi “Ymer” dhe amësi “Maxhe”, me datëlindje 6.7.1971, lindur në Fushë-Prezë, Tiranë, ka të njëjtat gjenealitete, të cilat i ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit. Në sistem nuk rezulton të jetë ndonjë person tjetër me këto të dhëna.

Gjithashtu në sistemin TIMS rezulton i regjistruar dhe shtetasi Jorgo Toto, me atësi “Imer” dhe amësi “Maxhe”, i datëlindjes 6.7.1971, pasaportë me nr. 20148497, i cili në sistem ka të njëjtën pamje në fotografi me shtetasin Agim Kajmaku.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me shkresën nr. 13255/1 prot, datë 27.8.2019, informon se pas verifikimeve të kryera shtetasi Agim Kajmaku (Jorgo Toto) nuk figuron i ndaluar/arrestuar nga strukturat e Policisë së Shtetit, si dhe ky shtetas nuk ka të regjistruara gjenealitete të tjera, përveç Agim Kajmaku dhe Jorgo Toto.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Emigracionin, me shkresat nr. 3269/1 prot, datë 29.8.2019 dhe nr. A-107/4 prot, datë 26.9.2019, ka vënë në dispozicion fotokopje të sistemit TIMS të shtetasit Agim Kajmaku dhe shtetasit Jorgo Toto.

Për një verifikim më të thelluar, bazuar në përcaktimet e nenit 8, të ligjit nr. 138/2015, është realizuar në datën 28.8.2019 marrja e gjurmëve të gishtave të subjektit Agim Kajmaku nga databaza e të dhënave të kompanisë ALEAT sh.p.k., e cila administron të dhënat biometrike të shtetasve shqiptare. Po kështu janë depozituar gjurmët daktiloskopike pranë Institutit të Policisë Shkencore në datën 3.9.2019, dhe nga vetë subjekti Agim Kajmaku.

Me shkresën nr. 931/1 prot, datë 29.8.2019, struktura e Verifikimit të Integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike pranë Prokurorisë së Përgjithshme, i ka dërguar Zyrës Qendrore Kombëtare Interpol, gjurmët daktiloskopike të shtetasit Agim Kajmaku për t’i verifikuar me autoritetet homologe të tyre jashtë vendit, duke e njohur me dyshimet e paraqitura në lidhje me arrestimin në flagrancë në territorin e shtetit grek në vitin 2003 dhe se ndaj tij pretendohet se është një filluar një proces penal dhe gjyqësor për “Përdorim dhe shpërndarje të kartëmonedhave të falsifikuara”.

Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tiranë, me shkresën nr. 10709/6 prot, datë 24.9.2019, ka sqaruar se nga informacioni i marrë nga zyra homologe Interpol Athinë/Greqi, rezulton se nga krahasimi daktiloskopik i gjurmëve të gishtave të shtetasit Agim Kajmaku, me gjurmët daktiloskopike që ndodhen në databazën e të dhënave kriminale të Greqisë, këto gjurmë përputhen me gjurmët e gishtave të shtetasit Jorgo Toto.

Me shkresën nr. 10709/9 prot, datë 22.10.2019, (protokolluar në Prokurorinë e Përgjithshme në datën 23.10.2019) Zyra Qendrore Kombëtare Interpol saktëson se nga informacioni i marrë nga zyra homologe Interpol Athinë/Greqi rezulton se shtetasi Jorgo Toto, i biri i Imer dhe Maxhe, me datëlindje 6.7.1976, gjurmët e të cilit përputheshin me gjurmët daktiloskopike të shtetasit Agim Ymer

Kajmaku, është arrestuar në datën 14.1.2003, për qarkullim monedhash të falsifikuara. Më 13.9.2019, sipas vendimit nr. 236/2019 të Gjykatës së Janinës, ky person është shpallur i pafajshëm. Sa më sipër autoritetet gjyqësore greke kanë revokuar urdhërarrestin kombëtar dhe evropian, për këtë shtetas.

Me shkresën nr. 931/2 prot, datë 30.8.2019 dhe shkresën nr. 931/8 prot, datë 14.10.2019 i është kërkuar Ministrisë së Drejtësisë, të komunikojë me autoritetet e drejtësisë së Republikës së Greqisë për të siguruar informacion dhe dokumentacion në lidhje me arrestime/ndalime; masa sigurimi personale, vendime dënimi penal; vendime dëbimi, në emër të shtetasit Agim Kajmaku alias Jorgo Toto. Kjo kërkesë është përcjellë nga Ministria e Drejtësisë te Ministria e Drejtësisë së Greqisë, në datën 4.9.2019. Aktualisht, nuk ka një përgjigje në lidhje me sa është kërkuar.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresat nr. 12186/1 prot, datë 11.9.2019 dhe nr. 13968/1 prot, datë 30.9.2019, ka informuar Prokurorinë e Përgjithshme se për periudhën nga data 1.1.2009 e deri në kthimin e përgjigjes, për shtetasin Agim Kajmaku (Jorgo Toto) rezulton:

Kallëzim penal nr. 3381/10, mbi bazën e të cilit në datën 21.9.2010 është regjistruar procedimi penal nr. 3825/10, për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Ky procedim penal është pushuar me vendimin e datës 15.2.2011.

Kallëzim penal nr. 11718/17, mbi bazën e të cilit në datën 25.9.2017 është regjistruar procedimi penal nr. 7664/17, për veprën penale të “Plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Ky procedim është pushuar me vendimin e datës 20.12.2017.

Bashkëlidhur kjo, prokurori ka vënë në dispozicion fotokopje të njehsuara me origjinalin të vendimeve të pushimit. Nga përmbajtja e dy vendimeve të pushimit rezulton që ndaj këtij subjekti nuk ka pasur arrest në flagrancë apo ndalim nga autoritetet policore dhe ndaj tij nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi gjatë procesit penal.

Nga informacioni i përcjellë nga prokuroritë e tjera pranë gjykatave të shkallës së parë, gjykatave të apelit dhe Prokuroria për Krime të Rënda, Tiranë, rezulton se ndaj subjektit Agim Kajmaku, nuk janë regjistruar procedime penale, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi dhe nuk është dënuar me vendim jopërfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

Për sa më sipër rezulton se verifikimi është kryer i plotë, i gjithanshëm dhe konstatohet se subjekti deklarues Agim Ymer Kajmaku, nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Nga verifikimet e kryera rezulton se subjekti ka qenë në hetim dhe është arrestuar në flagrancë për qarkullim monedhash të falsifikuara. Ndërkohë me vendimin datë 13.9.2019, nr. 236/2019, të Gjykatës së Janinës, është shpallur i pafajshëm. Gjithashtu ka qenë në hetim për dy raste nga Prokuroria e rrethit gjyqësor Tiranë, por në të dy rastet procedimet penale janë pushuar. Për këtë arsye subjekti nuk përfshihet në asnjë nga rastet e ndalimeve të parashikuara në nenin 2, të ligjit nr. 138/2015.

Ndërkohë Prokuroria e Përgjithshme, konstaton se subjekti deklarues, Agim Kajmaku (alias Jorgo Toto) përfshihet në përcaktimet e pikës 3, germa “ç”, kreu III-të, i vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, pasi:

Ligji nr. 138/2015 dhe vendimi i Kuvendit nr. 17/2016, përcaktojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar që subjektet kanë detyrimin ligjor të deklarojnë çdo informacion në lidhje me gjenealogjet e tyre aktuale e të mëparshme, rekordet kriminale brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë (vendime dënimi përfundimtare ose jo, hetime penale jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, masa sigurimi personale, vendime dëbimi, ndalime arrestime, hetime, etj.).

Vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, është miratuar bazuar në detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 138/2015. Vendimi nr. 17/2016 i Kuvendit, ka miratuar formularin e vetëdeklarimit, sipas formatit të përcaktuar në kreun e III-të të tij. Ndërkohë në kreun III-të, pika 3, germa “ç”, thuhet se “pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”.

Subjekti Agim Ymer Kajmaku me vullnetin e tij të lirë ka plotësuar formularin e vetëdeklarimit, ka nënshkruar në çdo faqe të tij, duke konfirmuar të dhënat që vetë ai ka paraqitur dhe njëkohësisht ka konfirmuar dijeninë e tij në lidhje me parashikimet e pjesës së II-të të formularit të vetëdeklarimit (faqe 2) “Marrija dijeni mbi efektet e formularit dhe të vetëdeklarimit”, ku, ndër të tjera thuhet se: germa “d”: “Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i mëtejshëm i funksionit publik.”.

Nga verifikimet e kryera nga Prokuroria e Përgjithshme është provuar se shtetasi Agim Kajmaku dhe shtetasi Jorgo Toto, është i njëjti person. Ky fakt konfirmohet nga të dhënat e sistemit TIMS, konfirmohet nga fakti që gjurmët daktiloskopike të shtetasis Agim Kajmaku dhe shtetasis Jorgo Toto tregojnë se është i njëjti person, por ky fakt është pranuar dhe nga vete subjekti, i cili ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit që ka përdorur emër/mbiemër Jorgo Toto.

Subjekti Agim Kajmaku, në përgjigje të pyetjes 3, faqe 4, të formularit të vetëdeklarimit: “A keni qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?”, ka deklaruar “jo”. Pra, rezulton se ai nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit procedimin penal të regjistruar ndaj tij nga autoritet Greke të drejtësisë për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara, si dhe faktin që ka qenë në gjykim nga autoritetet Greke të drejtësisë.

Subjekti Agim Kajmaku, në përgjigje të pyetjes 4, faqe 4, të formularit të vetëdeklarimit: “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një vepre penale”, ka deklaruar “jo”. Pra, rezulton se ai nuk ka deklaruar në formularin e vetëdeklarimit faktin që është arrestuar në flagrancë në datën 14.1.2003 në Greqi, për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara.

Nga verifikimet e kryera konfirmohet se subjekti Agim Kajmaku ka pasur dijeni të plotë në lidhje me faktin që ka qenë në hetim penal në Greqi dhe se ndaj tij kishte një proces gjyqësor penal në zhvillim. Kjo, sepse ai është arrestuar në flagrancë dhe ka dalë para gjykatës Greke ku i është bërë e ditur e gjithë procedura që do ndiqet ndaj tij. Nga ana tjetër rezulton se subjekti ka kryer veprime konkrete për fshehjen e këtij fakti para autoriteteve shqiptare, duke ndryshuar në datë 30.3.2004, emër/mbiemër nga “Jorgo Toto” në “Agim Kajmaku”, si dhe duke mos e deklaruar këtë fakt në formularin e vetëdeklarimit.

III

Referuar nenit 33, 42 dhe 47 të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve thirri si palë në këtë shqyrtim administrativ z. Agim Ymer Kajmaku, për të dhënë mendime dhe shpjegime për faktet dhe rrethanat e çështjes.

Përfaqësuesi me prokurë i z. Agim Kajmaku, avokat z. Isuf Shehu, përfaqësuar me prokurë, në pretendimet e tij deklaroi se:

1. Vendimi i Prokurorisë së Përgjithshme për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Agim Ymer Kajmaku është krejtësisht i gabuar, i paplotë dhe pa fakt, që bie ndesh me frymën e ligjit nr. 138/2015, i ndryshuar.

2. Detyrat e Prokurorisë së Përgjithshme janë të përcaktuara në kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, dhe nuk ka administruar asnjë provë shkresore në lidhje me një vendim të formës së prerë, që përmban dënimin ose vendosjen e masës së sigurisë apo mbi bazën e të cilës është lëshuar një urdhër kërkimi ndërkombëtar. Vendimi i Kuvendit nr. 17/2016 përcakton se administrimi i akteve bëhet në rrugë zyrtare, ndaj edhe procesi i verifikimit si një proces administrativ nuk mund të përfundojë sepse bie në kundërshtim me pikat 12, 13 e 14, të kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, të cilat kërkojnë që vendimmarrja të merret bazuar në punën e Prokurorisë dhe jo opinionet e saj.

3. Sa i takon çështjes së mospasqyrimin në “formularin e vetëdeklarimit” të fakteve lidhur me ndonjë masë sigurimi ose urdhër kërkimi ndaj personit të tij, parashikimi i germës “ç”, të pikës 3, kreu III, i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nuk përbën një ndër rastet e ndalimit të parashikuar në nenin 2, të ligjit 138/2015, bazuar edhe në praktikën e ndjekur nga vetë KQZ-ja dhe nuk ka asnjë të dhënë që të përfshihet në kushtet e nenit 2, të ligjit 138/2015.

4. Bazuar në vetë rezultatet e verifikimit të Prokurorisë subjekti nuk përfshihet në fushën e veprimit të nenit 2, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” mbi bazën e të cilit KQZ-ja duhet të marrë vendim.

5. Të lejohet z. Agim Ymer Kajmaku, të vazhdojë të ushtrojë funksionin e kryetarit të Bashkisë Vorë, qarku Tiranë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të rezultateve të verifikimit nga Prokuroria e Përgjithshme, vlerëson se për sa i përket procedurave të ndjekura, për rezultatet e verifikimit në lidhje me të dhënat në formularin e deklarimit, referuar pikës 1 dhe 2, të nenit 8, të ligjit 138/2015 dhe pikës 5, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë, është kompetencë e Prokurorisë së Përgjithshme.

Në Kreun III, pika 3, “ç”, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit parashikohet se:

“...pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota dhe të pasakta në të, passjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik”.

Gjithashtu, subjektet mbajnë përgjegjësinë e plotë dhe janë të vetëdijshëm për pasojat ligjore në rast të deklarimeve të pavërteta, të paplota dhe të pasakta, në lidhje me të kaluarën e tyre. Duke nënshkruar në pikën II të formularit: “Marrja dijeni mbi efektet e formularit të vetëdeklarimit”, shkronja “d”: “Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta, të paplota, dhe të pasakta në këtë formular dhe refuzimi i depozitimit të gjurmëve daktiloskopike, passjell skualifikimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo ushtrimi i menjëhershëm i funksionit publik.”.

Nga dokumentacioni i përcjellë, konkludohet se subjekti nuk ka deklaruar informacionet që lidhen me hetimet në ngarkim të tij, pavarësisht detyrimit ligjor që buron nga pyetja 3, e formularit të vetëdeklarimit i cili parashikon: “A keni qenë ndonjëherë në hetim apo gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre penale?”.

Duke mos i pasqyruar faktet e mësipërme në formular, konkludohet se veprimi i tij bie në fushën e zbatimit të pikës 3/ç, të kreut III, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe rezultatit të verifikimit të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme vlerëson se:

Prokuroria e Përgjithshme, ka kryer verifikimin e të dhënave dhe referuar informacionit të ardhur nga Interpol/Athina/Greqi, ka konstatuar se funksionari z. Agim Ymer Kajmaku (alias Jorgo Toto) është arrestuar në datën 14.1.2003, në Greqi, për qarkullim monedhash të falsifikuara. Deri në datën 13.9.2019, datë kur është marrë vendimi 236/2019 i Gjykatës së Janinës, ku është shpallur i pafajshëm, rezulton se ndaj tij ka pasur urdhërarresti kombëtar (grek) dhe evropian, për këtë shtetas.

Duke qenë se funksionari publik është përgjigjur me “jo” pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit: “A keni qenë ndonjëherë në hetim apo ne gjykim nga një autoritet i huaj për kryerjen e një vepre

penale?” dhe “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese për kryerjen e një veprë penale”, rezulton se ai nuk ka deklaruar se ndaj tij ka pasur hetim, ndalim, apo gjykim nga autoritetet ligj zbatuese Greke. Gjithashtu funksionari i është përgjigjur me “jo” pyetjeve të formularit të vetëdeklarimit: “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?” dhe “A është marrë ndonjëherë për ju masa e dëbimit nga një shtet i huaj”, rezulton se ai nuk ka deklaruar se ndaj tij ka pasur masë shtrënguese e sigurisë personale apo masë dëbimi.

Personi i cili sipas autoriteteve greke është arrestuar dhe gjykuar për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara ka përdorur të dhëna identiteti Jorgo Toto, të cilat nga analiza e gjurmëve të gishtave përputhen me të dhënat aktuale të z. Agim Ymer Kajmaku.

Neni 2, pika 3, i ligjit 138/2015, parashikon se “Ndalimet e parashikuara në këtë nen zbatohen edhe ndaj personave që, në kohën e kryerjes apo tentativës së kryerjes të veprës penale, të parashikuar në këtë ligj, mbanin të dhëna identiteti të ndryshme nga ato që mbajnë në momentin kur zbatohet ndalimi ndaj tyre.

Subjekti z. Agim Ymer Kajmaku rezulton se ka përdorur në shtetin grek gjenealitete të tjera, të deklaruar si Jorgo Toto në formularin e vetëdeklarimit, por nuk ka deklaruar arrestimin e tij dhe faktin që në momentin e kandidimit ndaj tij ka qenë në fuqi një urdhërarresti kombëtar në shtetin grek dhe urdhërarresti evropian.

Kreu III, pika 3, germa “ç” parashikon: “Formulari i vetëdeklarimit përmban detyrimisht një rubrikë ku pasqyrohet se ... *Pasqyrimi i të dhënave të pavërteta të paplota dhe të pasakta në të pasjell përjashtimin e menjëhershëm dhe në çdo kohë nga kandidimi/zgjedhja/emërimi apo nga funksioni publik.*”.

Në lidhje me faktin nëse mosdeklarimi i të dhënave të cilat parashikohen në pyetjet e formularit të vetëdeklarimit, përbëjnë shkak për ndalimin e ushtrimit të funksionit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, është shprehur gjerësisht rast pas rasti dhe në vendimet e mëparshme, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 138/2015¹. Gjithashtu vendimet e KQZ-së për raste të ngjashme janë ankuar në rrugë gjyqësore dhe Gjykata Administrative i ka lënë në fuqi.²

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar praktikave të deritanishme ka vlerësuar individualisht për çdo funksionar publikë të trajtuar sipas ligjit 138/2015, të dhënat e padeklaruar, arsyen nëse fshehja e tyre nga deklarimi është e qëllimshme apo jo.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referuar gjetjeve të Prokurorisë së Përgjithshme në vendimin e rezultatit të Verifikimit në zbatim të ligjit 138/2015, për z. Agim Ymer Kajmaku me funksion kryetar i Bashkisë Vorë, konstaton se:

Më datë 13.9.2019, sipas vendimit nr. 236/2019 të Gjykatës së Janinës, subjekti Agim Ymer Kajmaku, alias Jorgo Toto, është shpallur i pafajshëm për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara. Sa më sipër bazuar në këtë vendim pas kësaj date autoritetet gjyqësore Greke kanë revokuar urdhërarrestin kombëtar dhe evropian, për këtë shtetas.

Subjekti z. Agim Kajmaku në datën e fillimit të detyrës (5 gusht 2019) nuk ka deklaruar faktin e procedimit penal të regjistruar ndaj tij nga autoritetet greke të drejtësisë për veprën penale të qarkullimit të monedhave të falsifikuara, faktin që ka qenë në gjykim nga autoritetet Greke të drejtësisë, apo që ai ka qenë arrestuar dhe se ndaj tij ka pasur urdhërarresti në fuqi në shtetin Grek, dhe urdhërarresti evropian në fuqi, me gjenealitetet Jorgo Toto.

Në lidhje me fuqinë prapavepruese të ligjit nr. 138/2015, i referohemi jurisprudencës gjyqësore. Kështu, në vendimin 80-2017-422, datë 10.2.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë (vendimi ka marrë formë të prerë, pasi nuk është ankimuar) shprehet (në atë rast, në lidhje me ish-

¹ Vendimet e KQZ-së për çështjen G. Rahovica dhe A. Rakipi, respektivisht nr. 3 dhe 4, datë 5.1.201.

² Vendimet e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë nr. 80-2018-4702, datë 24.12.2018 dhe nr. 416(80-2019-432), datë 12.2.2019.

deputetin, z. Dashamir Tahiri) se: “pavarësisht se paditësi në datën 29.12.2016 duhej konsideruar si i rehabilituar, mandati i tij si deputet i fituar përmes bërjes së betimit në fillim të shtatorit 2013, është mandat i fituar në kushtet e ndalimit sipas ligjit nr. 138/2015. Konkretisht, bazuar në nenin 14, paragrafi 3 të tij, llogaritja e periudhës së ndalimit fillon nga data e fillimit të detyrës apo e mandatit në vazhdim dhe shtrihet në periudhën që i paraprin kësaj periudhe.”

Në këto kushte, funksionari publik ka paraqitur rrethana apo të dhëna të rreme në formularët e vetëdeklarimit, depozituar në Komisionin Qendror të zgjedhjeve në datën 13.5.2019.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar gjetjeve të Prokurorisë së Përgjithshme vlerëson se mosdeklarimi në formularin e vetëdeklarimit, dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në datën 13.5.2019, të arrestimit, hetimeve dhe vendosjes ndaj tij të urdhërarrestit dhe fshehja e tyre, ka qenë me qëllim, për të penguar institucionet e ngarkuara nga ligji nr. 138/2015, për të kryer verifikim të plotë dhe të gjithanshëm, duke qenë se në momentin e plotësimit dhe të dorëzimit të formularit të vetëdeklarimit në KQZ, ende nuk kishte përfunduar gjykimi i çështjes penale në ngarkim të këtij subjekti dhe respektivisht nuk dihej sesi do të ishte vendimmarrja e gjykatës përkatëse.

Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2016”, shprehet se: “... *Qëllimi i ligjit nr. 138/2015, është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, të institucioneve të pavarura dhe atyre të krijuara me ligj, si dhe të administratës publike, nëpërmjet pengimit të zgjedhjes ose emërimit në to apo largimit nga funksioni publik i atyre personave, për të cilët ekzistojnë shkaqet ligjore për të mos u kandiduar, për t’u zgjedhur apo emëruar, por jo të personave që, për një arsye që nuk lidhet me fshehjen e qëllimshme, kanë referuar të dhëna të ndryshme apo të paplota në raport me të dhënat e gjendura në regjistrat.*³ ...)

Sipas interpretimit të Kuvendit vetëm nëse fshehja e të dhënave është e paqëllimshme funksionari nuk është në kushtet për ndalimin e zgjedhjes ose emërimit, apo largimit nga funksioni publik.

Në kuadër të zbatimit të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, informacion i ardhur nga institucioni i Prokurorisë krijon bindjen se funksionari ka shkelur dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me zbatimin e drejtë, transparencën dhe frymën me të cilën funksionon ligji nr. 138/2015, “Për verifikimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen dhe ushtrojnë funksione publike”, dhe rregullimet e detajuara të parashikuara në vendimin nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, vlerëson se funksionari publik, kryetar i Bashkisë Vorë, z. Agim Ymer Kajmaku, referuar gërmës “ç”, pikës 3, kreut III, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, është në kushtet për ndalimin e ushtrimit të funksionit.

Referuar nenit 10, pika 1, germa “d”, kur verifikohen kushtet për moszgjedhje apo moskandidim, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të funksionarit publik.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa “a”, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 10, pika 1, germa “d”, i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe kreut III pika 3, germa “ç”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOSI:

³ Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë (faqe 2)

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Vorë, qarku Tiranë, z. Agim Ymer Kajmaku.
2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë Kryeministrit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.